Fyerjet nuk janë ilaç për rikuperimin e ekonomisë pas koronavirusit

Numri i madh i të ashtu quajturave portaleve që "mbijnë" sikur kërpudhat pas shiut, servojnë informacione pafund, thua se një ushtri e tërë gazetrësh dhe personel tjetër mediatik kanë të angazhuar. Në faktë, ata arrijnë kaq shumë lajme të publikojnë falë "copy-paste", thjeshtë duke vjedhur lajme. Më e keqja, ata edhe shtrembërojnë informacionin origjinal, vetëm për klimikme. Në vend të fakteve, ata sjellin mendimet e tyre, duke harruar se kodi i gazetarëve përcakton në mënyrë të qartë se gazetarët duhet të bëjnë dallim ndërmjet fakteve dhe mendimeve, ndërmjet lajmit dhe komentit. Në tekstin që analizojë, e gjithë kjo është ngatërruar, faktet dhe mendimet nuk janë ndarë, ndërsa në titulli është përdorur fyerje. Kur të gjithë kësaj i shtojmë edhe situatën e fundit me pandeminë nga virusi Covid - 19, s'ka se si të mungojnë këto ngatërrime për një klikim më tepër.

Me datë 10 Prill 2020, titulli "Ministri Ahmetaj përtypet kur dëgjon paketën e ndihmës në Maqedoninë e Veriut", të shfaqet në faqet e shumë medianle on-line.



Në fakt, titulli origjinal është: "**Përballja Ahmetaj-Bekteshi, masat ekonomike që ka marrë Shqipëria dhe Maqedonia**", të cilin e gjeni në ueb faqen e Tv Klan Shqipër, aty ku mbahet emisioni "Opinion" e ku flasin të dy ministrat.

Te televizoni teksti dhe titulli aspak nuk janë të njejtë me tekstin që kanë përpunua mediat tjera që citojnë. Këta të fundit, (ose njëra, pasi të tjerët e kanë vjedhur), bëjnë favorizim të njërit dhe fyejnë ministrin tjetër. Te ueb faqa e televizonit gjendet edhe video ku në asnjë moment ministri nga Shqipëria nuk duket duke u "përtypur" derisa dëgjon kolegun e tij nga

Maqedonia.



Pastaj, këtë artikull të përpunuar e gjeni në mediat on-line në Shqipëri, Kosovë e në Maqdoninë e Veriut.

Pra, teksti është marrë kryesisht nga një medie tjetër dhe ajo pjesë e informacionit është plotësisht e saktë, te e cila janë përdorur pjesë të bisedës dhe në mënyrë adekuate janë të veçuara pyejet e gazetarit me përgjigjet e dy bashkëbiseduesve.

Mirëpo, problemi lind kur në artikullin që analizojmë, shtohen, si: ministri i etnitetit shqiptarë nga Maqedonia e Veriut, bëhet "ministri maqedonas", ministri nga Shqipëria "përtypet", kur flet kolegu i tij "maqedonas", etj.

I tillë është shembulli i këtij fragmenti:

- Kur u përballë me këtë shifër, Ahmetaj u përtyp nga sikleti, pasi një shtet shumë herë më i vogël se Shqipëria, ndihmon më tepër biznesin. Ai e pyeti sërish kolegun maqedonas për fondin që kishte alokuar për biznesin dhe në disa momente shihej tensioni që Ministri Ahmetaj kishte në studio. Kohët e fundit, Ministri i Covidit, Arben Ahmetaj, është vënë në kritika të forta për mënyrën selektive që do të përdoret për

mbështetjen e biznesit, me 100 milionë euro kredi. Përveç dyshimeve për selektivitet, akuzat janë se biznesi po falimentohet duke i detyruar të marrin kredi mbi kredi".

> Kur u përballë me këtë shifër, Ahmetaj u përtyp nga sikleti, pasi një shtet shumë herë më i vogël se Shqipëria, ndihmon më tepër biznesin. Ai e pyeti sërish kolegun maqedonas për fondin që kishte alokuar për biznesin dhe në disa momente shihej tensioni që Ministri Ahmetaj kishte në studio.
>
> Kohët e fundit, Ministri i Covidit, Arben Ahmetaj, është vënë në kritika të forta për mënyrën selektive që do të përdoret për mbështetjen e biznesit, me 100 milionë euro kredi. Përveç dyshimeve për selektivitet, akuzat janë se biznesi po falimentohet duke i detyruar të marrin kredi mbi kredi.

Në këtë paragraf, ndër të tjera, ministrin nga Shqipëria për Shtetin, Sipërmarrjen, Rindërtimin, e quajnë edhe Ministri për Covidin. Kështu që ky formulim, përveç që është i panevojshëm, është edhe i palogjikshëm.

Sipas Kodit të Gazetarëve, gazetari duhet ta kultivojë kulturën e të folurit dhe etikën. Komunikimi i pasjellshëm me opinionin nuk ka të bëjë aspak me profesionin e gazetarit. Mirëpo, pavarësisht praktikës së mirë gazetareske, ky tekst ka një numër kualifikimesh fyese dhe stereotipesh.

Domethënë, një njoftimi shumë korrekt dhe të saktë që është marrë nga një medie tjetër, janë shtuar elemente të tilla si: fotografia, emri dhe mbiemri, fyerje, të cilat, nga ana tjetër, mund të bëjnë që personi të sulmohet verbalisht, ndërsa tjetri të ngritet në pidedestal.

Në mediat profesionale, komentet dhe zhanret e informacionit janë të ndara nga njëra-tjetra, ndërsa fyerjet nuk përdoren si armë kundër askujt, pavarësisht se çfarë ndjenjash të forta veprimet e pretenduara të dikujt i shkaktojnë autorit.

Për në fund, sigurisht që Virusi Covid - 19 pos shëndetit, ka goditur edhe ekonominë e çdo vendi në botë, por këto analiza dhe krahasime do të bëhen pas kalimit të paandemisë dhe sërisht nga njerëz profesionistë. Gazetarët sërisht do të parashtrojnë qyetje dhe tekstet e tyre do të duhet të vazhdojnë edhe atëherë i shkruajnë vetëm duke u bazuar në fakte.

Autor:
Onur Bayramoğlu, 15 vjeçare